



REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Primar / Dorezuar Punëjeto / Prodato Received / Delivered	26-04/2021	1 viti god year
Organ / Rrjeta Organ / Jedinica Org / Unit	SKIPNOSTICK 2005/2021	Shtesa Prilog Appendix
		Sasia Kolicina Quantity
		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 150/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.150/2021 të datës 17.03.2021 të parashtruar nga ankuesit si dhe ne adresë banimi fsh Orrobërae komuna e Istogut, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.04.2021, në mënyrë unanime mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.150/2021 e datës 17.03.2021, e parashtruar nga ankuesit si dhe

A r s y e t i m

Ankuesit i punësuar në pozitën "Drejtor i Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë, e punësuar "Inspektore në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë" Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit, i punësuar në pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit si dhe e punësuar në pozitën "Inspektore në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit më datë 17.03.2021, Nr. Prot:1208/2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim mbi pagën bazë për punën specifike të punonjësve të Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.03.2021, ka proceduar tek Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën



29.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat lëndës nga Ministria Kulturës Rinis dhe Sportit .

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesit me datën 17.03.2021, me numër të protokollit 1208/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 05.03.2021 me numër të protokollit 678/2021 të parashtruar nga ankuesit tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike; Emalin e datës 11.03.2021; Emalin e datës 10.03.2021; Emali i datës 09.03.2021; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit me numër 1060/2020/02 të datës 11.03.2020 për ankuesin Aktin e Emërimit me numër 2461/2020/02 të datës 15.07.2020 të ankueses Aktin e Emërimit me numër 190/2019 të datës 28.01.2019 të ankuesit Aktin e Emërimit me numër 196/2019/02 të datës 28.01.2019 të ankueses Labëri Dakaj; Emalin e datës 17.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1323/2021 të datës 23.03.2021 të proceduar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës tek Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit ; Përgjigjen në ankesë me numër 1454/2021 të datës 29.03.2021 nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve
si dhe është e pa bazuar sepsë:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve, të cilët pretendojnë që duke parë se çfarë pozita mbajnë i takon kompensimi mbi pagën bazë për punën specifike të punonjësve.

Me datë 05.03.2021 ankuesit si dhe kanë parashtruar kërkesën me numër të protokollit 678/2021 për aprovimin e shtesave mbi pagën bazë, tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, me pretendimet ankimore se në përputhje me ligjin Nr.03/L-147 për pagat e nëpunësve civil, rregulloren nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, rregulloren Nr.1/2020 për kompetencat, autorizimet dhe procedurat e inspektimit dhe ankesave të inspektoratit për trashëgimi kulturore, ju takon kompensimi. Me datën 09.03.2021 Asistentja Administrative në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes emalit zyrtar i është drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme z. duke kërkuar që të shqyrtohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit, ndërsa me datën 10.03.2021 drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik me emali zyrtar i është drejtuar z që kërkesa e parashtruar nga grupi i ankuesve në Ministrinë Kulturës Rinis dhe Sportit të shqyrtohet.

zyrtar i lartë i politikave të personelit më datë 10.03.2021 për mes emalit ka njoftuar ankuesin lidhur me kërkesën e datës 05.03.2021 se: "DMZP ende nuk e ka themeluar Komisionin që do të merrej me shqyrtimin e kërkesave të institucioneve të SHCK-së që kanë të bëjnë me e shtesat mbi pagën bazë të çfarëdo natyre qofshin ato, pas themelimit të këtij komisioni, nëse ju në ndërkohë informoheni për themelimin e këtij komisioni e përsëritni edhe një herë kërkesën tuaj.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 14 ku përcaktohet se "Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut", dhe nenin 17 ku parashihet se 1. Për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është shumë më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit për ato pozita ose lloje të pozitave nga administrata publike, ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitave. 2. Kërkesa për miratimin e kësaj shtese nga Qeveria duhet të bazohet në një analizë, e cila tregon se për këto pozita ose lloje të pozitave: 2.1. çmimi i tregut për aftësitë në fjalë është shumë më i lartë se paga që ofrohet nga Shërbimi Civil; 2.2. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve është e papranueshme; 2.3. pritet se shtesa do të ndikojë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit. 3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e shumës së shtesave mbi pagën bazë për kushtet e tregut përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa"

Po ashtu Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 përcakton se: "Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut, institucioni duhet t'i ofrojë ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën që përmban: 2.1 Arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut për pozitën përkatëse, së bashku me një analizë, e cila dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, duke përfshirë informata mbi nivelin e pagës që paguhet nga organizatat e tjera në tregun e Kosovës për pozita të ngjashme. 2.2 Listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë dhe 2.3 Koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushtet e tregut të punës".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesit, me faktin e adresimit të kërkesës në ministrinë përgjegjëse për aprovim të shtesave për këtë lloj kategorie, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të përcaktuara me Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ndërsa është kompetencë e Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike respektivisht Ministrisë së Punëve të Brendshme që në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Financa, të kërkojnë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozita të caktuar ashtu siç është definuar me nenin 8 të kësaj Rregullore, ndërsa është kompetencë e këtij komisioni që në pajtim me nenin 8 paragrafin 3 Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, të vendos me kërkesat për shtesë mbi pagën bazë.

Kolegji konstaton se kjo çështje duhet të rregullohet duke u bazuar në legjislationin e potencuar më lartë ndërsa poashtu, Komisioni që do të merrej me shqyrtimin e kërkesave të institucioneve të Shërbimit Civil të Kosovës që kanë të bëjnë me realizimin e shtesave mbi pagën bazë të çfarëdo natyre qofshin ato nuk është funksional dhe nuk ka ende vendim për themelimin të këtij, atëherë kërkesa e ankuesit e parashtruar në ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka bazë ligjore, Andaj mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve janë të pa bazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.150/2021, datë 26/04/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

